

Qershor 2021

# SHQIPËRI: SHKARKIMI I PRESIDENTIT, NË VARËSI TË PËRKUFIZIMIT "SHKELJE E RËNDË" E KUSHTETUTËS

## Analizë dhe Skenarët e mundshëm

*Vendimi i Kuvendit për shkarkimin e Presidentit Ilir Meta ka shkaktuar mjaft tension në Shqipëri. E gjithë vëmendja është e drejtuar në Gjykatën Kushtetuese, e cila do të vendosë përfundimisht nëse Presidenti do të shkarkohet, apo do të vazhdojë të ushtrojë funksionin e tij. Gjykatës do t'i duhet të përcaktojë edhe kuptimin e termit "shkelje e rëndë" e Kushtetutës, në mungesë të një përkufizimi kushtetues dhe ligjor. Po ashtu, është ende e pasigurt se çfarë do të ndodhë pas një vendimi të mundshëm të Gjykatës. Skenarë të ndryshëm janë të mundshëm, ndërsa i gjithë procesi do të jetë një sfidë politike dhe ligjore*

## PËRMBLEDHJE

Më 9 qershor 2021, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi për shkarkimin e Presidentit Ilir Meta.<sup>1</sup> Kjo është hera e dytë që Partia Socialiste tenton të shkarkojë Presidentin; në vitin 2019, deputetë të Partisë Socialiste akuzuan Presidentin Ilir Meta për shkelje të Kushtetutës pas anulimit të zgjedhjeve vendore, me ç'rast, një Komision Hetimor është krijuar për të hetuar dhe për të raportuar për gjetjet. Para publikimit të raportit, Komisioni Hetimor kërkoi opinionin e Komisionit të Venecias. Ky i fundit arriti në përfundimin se edhe pse Presidenti kishte tejkalar kompetencat e tij kushtetuese, shkeljet e tij nuk përmbushin kriteret për shkarkim.<sup>2</sup> Këtë herë akuzat nuk lidhen me ndonjë akt konkret të nxjerrë nga Presidenti. Pretendimet për shkelje të rëndë të Kushtetutës u referohen deklaratave të ndryshme të bëra nga Presidenti para dhe gjatë zgjedhjeve parlamentare.

104 nga 122 deputetë votuan për shkarkimin e Presidentit.<sup>3</sup> Ky i fundit i hodhi poshtë të gjitha akuzat, duke këmbëngulur se Kuvendi nuk ka legjitimitetin për të bërë një gjë të tillë.<sup>4</sup>

<sup>1</sup> U.S.News, "Kuvendi i Shqipërisë shkarkon Presidentin për komentet e tij për votimet" ["Albanian Parliament Impeaches President for Vote Comments"], 9 qershor 2021, <https://www.usnews.com/news/world/articles/2021-06-09/albanian-parliament-impeaches-president-for-vote-comments>

<sup>2</sup> Opinioni i Komisionit të Venecias, 14 tetor 2019, [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)019-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)019-e)

<sup>3</sup> U.S.News, "Kuvendi i Shqipërisë shkarkon Presidentin për komentet e tij për votimet" ["Albanian Parliament Impeaches President for Vote Comments"], 9 qershor 2021, <https://www.usnews.com/news/world/articles/2021-06-09/albanian-parliament-impeaches-president-for-vote-comments>

<sup>4</sup> Në shkurt 2019, deputetë nga Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim hoqën dorë nga mandatet e tyre në përpjekje për të përmbysur qeverinë. Që prej asaj periudhe, Kuvendi ka funksionuar me 122 nga 140 deputetë që duhet të ketë, ndërkohë që shumica absolute janë mbështetës të Partisë Socialiste. Presidenti dhe mbështetësit e tij pretendojnë se një përbërje e tillë

Më 14 qershor 2021, Kuvendi e dërgoi vendimin për shkarkim në Gjykatën Kushtetuese, e cila duhet të nxjerrë një vendim brenda tre muajve. Derisa është e qartë se Gjykata Kushtetuese mund ta shkarkojë Presidentin, ose të shfuqizojë vendimin për shkarkim, mbetet mjaft e paqartë se çfarë do të ndodhë më pas. Për më tepër, Gjykatës Kushtetuese do t’i duhet të punojë me dispozita të paqarta kushtetuese dhe ligjore. Përkatesisht, nuk ekziston asnjë përkufizim kushtetues apo ligjor për “shkeljen e rëndë” të Kushtetutës për të cilën mund të shkarkohet Presidenti. Në mungesë të dispozitave të tilla, Gjykata Kushtetuese mund të kërkojë paraprakisht opinionin e Komisionit të Venecias.

Gjykatës Kushtetuese do t’i duhet të punojë intensivisht dhe të marrë vendimin sa më shpejt që të jetë e mundur, ose gjithçka do të shtyhet për në muajin shtator. Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, duket se opsioni i dytë është më i mundshëm. Megjithatë, nëse Ilir Meta është ende President kur të konstituohet Kuvendi i ri në shtator, atij do t’i duhet t’i japë mandatin kandidatit për formimin e qeverisë së re, Edi Ramës. Kjo do të jetë një situatë e pafavorshme për të dy palët, sidomos pas vendimit të Kuvendit për shkarkim, dhe kriza të tjera politike mund të pasojnë.

Duket se shkarkimi i Presidentit Ilir Meta do të jetë një proces mjaft i gjatë, me një fund të pasigurt. Kjo do të jetë rezultat i:

mungesës së qartësisë kushtetuese dhe ligjore, dhe mungesës së precedentëve, duke qenë se ky është rasti i parë që ndodh në Shqipëri, që pas rënies së sistemit komunist.

Si rrjedhojë, kjo situatë ka sjellë debate, interpretime, analiza e rekomandime të ndryshme, teksa pritet me padurim se si do të përfundojë ky proces.

## PËRSHKRIM I SHKURTËR I NGJARJEVE

Periudha parazgjedhore në Shqipëri ishte mjaft e ngarkuar. Vetëm dy ditë para zgjedhjeve, kryetari i Partisë Socialiste dhe Kryeministri në detyrë Edi Rama njoftoi se do të niste procedurat për shkarkimin e Presidentit Meta, nëse ky i fundit nuk do të jepte dorëheqjen pas zgjedhjeve.<sup>5</sup> Pak javë më parë, vetë Presidenti kishte premtuar dorëheqjen, nëse Edi Rama do të fitonte 71 mandate nga zgjedhjet.<sup>6</sup> Gjithsesi, edhe pse Edi Rama fitoi 74 mandate, Presidenti refuzoi të japë dorëheqjen me pretendimin se votat ishin manipuluar. Kjo nuk është hera e parë që Presidenti Ilir Meta hedh akuza të tilla kundër Edi Ramës. Para zgjedhjeve, ai madje kishte deklaruar se njerëzit do të dilnin në rrugë nëse Edi Rama do të përpiqej të manipulonte zgjedhjet. Në fund, Partia Socialiste (PS) fitoi zgjedhjet


---

e Kuvendit e lë këtë të fundit pa legjitimitetin politik apo moral për të nisur shkarkimin e tij. Për më tepër, Meta argumenton se Kuvendi aktual është në periudhë tranzicioni pas zgjedhjeve, me mandatin që i mbaron në shtator 2021, prandaj nuk ka kompetencë për të kryer veprimtari hetimore.

<sup>5</sup> Gazetaexpress, “Edi Rama paralajmëron lëvizjen e radhës ndaj presidentit Meta: Ka dy skenarë”, 23 prill 2021, <https://www.gazetaexpress.com/edi-rama-paralajmëron-levizjen-e-radhes-ndaj-presidentit-meta-ka-dy-skenare/>

<sup>6</sup> BalkanWeb “Ilir Meta: Jap dorëheqjen më 26 prill, nëse Edi Rama fiton 71 mandate pa prekur votat!”, 1 mars 2021, <https://www.balkanweb.com/ilir-meta-jap-doreheqjen-me-26-prill-nese-edi-rama-fiton-71-mandate-pa-prekur-votat/>

duke siguruar 74 vende në Kuvend, aq sa kishte fituar edhe nga zgjedhjet e kaluara.



Më 30 prill 2021, pak ditë pas fitores në zgjedhje, Partia Socialiste i kërkoi Kuvendit nisjen e procedurave për shkarkimin e Presidentit Ilir Meta. Sipas deputetëve të kësaj partie, Meta kishte bërë deklarata të njëanshme politike para dhe gjatë zgjedhjeve. Ata e akuzuan Presidentin për nxitje të dhunës dhe, rrjedhimisht, shkelje të Kushtetutës.<sup>7</sup> Për të hetuar veprimtarinë e Presidentit Ilir Meta, Kuvendi ngrii një Komision Hetimor, i cili arriti në përfundimin se Presidenti kishte shkelur rëndë Kushtetutën dhe propozoi shkarkimin e tij.<sup>8</sup> Mes të tjerash, Komisioni deklaroi se “[...] Presidenti ka cenuar rolin dhe pozitën e tij kushtetuese si kreu i shtetit dhe si përfaqësuesi i unitetit kombëtar.”<sup>9</sup> Duke marrë parasysh shkelje të tilla, Komisioni arriti në përfundimin se Presidenti Ilir Meta “nuk mund të vazhdojë të ushtrojë rolin e tij si President”.<sup>10</sup> Kështu, më 9 qershor 2021, Kuvendi miratoi raportin e Komisionit dhe vendosi për shkarkimin e Presidentit të Republikës.

Nëse nuk jep dorëheqjen, Ilir Meta do të vazhdojë të ushtrojë detyrën e tij si President, në pritje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

## PROCEDURA PËR SHKARKIMIN E PRESIDENTIT

Procedura për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë përcaktohet nga:

- Neni 90** (2) (3) i Kushtetutës së Shqipërisë<sup>11</sup>
- Neni 112** i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë<sup>12</sup> dhe

<sup>7</sup> AA “Partia Socialiste kërkesë Kuvendit të Shqipërisë për shkarkimin e presidentit Meta”, 3 maj 2021, <https://www.aa.com.tr/sq/ballkani/partia-socialiste-k%C3%ABrkes%C3%AB-kuvendit-t%C3%AB-shqip%C3%ABris%C3%AB-p%C3%ABr-shkarkimin-e-presidentit-meta/2228103>

<sup>8</sup> Raport Përfundimtar i Komisionit Hetimor, maj 2021, <https://www.parlament.al/Files/Lajme/Dokument/RAPORT%20P%C3%8BRFUNDIMTAR%20I%20KOMISIONIT%20HETIMOR.pdf>

<sup>9</sup> Ibid.

<sup>10</sup> Ibid.

<sup>11</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: [http://www.pp.gov.al/web/kushtetuta\\_2016\\_1082.pdf](http://www.pp.gov.al/web/kushtetuta_2016_1082.pdf)

<sup>12</sup> Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë: <https://www.parlament.al/Files/sKuvendi/rregullorja.pdf>

### 3. Nenet 61-63 të Ligjit “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.<sup>13</sup>

Procedura për shkarkimin e Presidentit kalon nëpër fazat procedurale të shpjeguara më poshtë. Hapi i parë është kërkesa e deputetëve për shkarkimin e Presidentit. Procedura vazhdon në Parlament, i cili, pasi të votojë pro shkarkimit, e kalon çështjen në Gjykatën Kushtetuese. Nëse vendos të vazhdojë me shqyrtimin gjyqësor të çështjes, Gjykata do të duhet të marrë një vendim. Vendimi për shkarkimin e Presidentit merret me shumicë votash, që është 7 nga gjithsej 9 gjyqtarë.<sup>14</sup> Megjithatë, për rastin në fjalë, Gjykata Kushtetuese është në proces të emërimit të gjyqtarëve të rinj për të plotësuar përbërjen e saj prej 9 anëtarësh. Aktualisht, Gjykata funksionon me vetëm 7 gjyqtarë, kështu që do të duhen 5 vota për shkarkimin e Presidentit.<sup>15</sup>

#### KUVENDI

##### PROPOZIMI

Jo më pak se 1/4 e të gjithë deputetëve mund të propozojnë shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës duke i paraqitur kërkesën Kuvendit.

Kërkesa i paraqitet me shkrim Kryetarit të Kuvendit

Kryetari i Kuvendit ia përcjell kërkesën dhe dokumentet shoqëruese të saj Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Komisioni i paraqet Kuvendit raportin dhe propozimin e tij për ngritjen e një komisioni hetimor.

Kuvendi voton, jo më vonë se 7 ditë nga marrja e raportit, për ngritjen e Komisionit Hetimor.

Komisioni Hetimor i paraqet Kuvendit raportin me propozimin për shkarkimin e Presidentit.

Kuvendi miraton raportin e Komisionit Hetimor dhe vendos për shkarkimin e Presidentit me 2/3 e të gjithë anëtarëve të tij.

Vendimi i Kuvendit për shkarkimin e Presidentit të Republikës i dërgohet Gjykatës Kushtetuese nga Kryetari i Kuvendit brenda 5 ditëve .

##### GJYKATA KUSHTETUESE

Shumica e anëtarëve të Gjykatës votojnë për kalimin e çështjes në seancë plenare.

Brenda tre muajve, Gjykata Kushtetuese merr vendimin për shkarkimin ose jo të Presidentit.

<sup>13</sup> Ligji Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë: [http://www.gjk.gov.al/web/ligj\\_per\\_organizimin\\_dhe\\_funksionimin\\_e\\_gjykes\\_kushtetuese\\_2016\\_1667.pdf](http://www.gjk.gov.al/web/ligj_per_organizimin_dhe_funksionimin_e_gjykes_kushtetuese_2016_1667.pdf)

<sup>14</sup> Ligji Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Neni 72 (2)

<sup>15</sup> Një gjyqtar në vitin 2018 dhe një tjetër në vitin 2019 u shkarkuan nga Gjykata Kushtetuese, duke e lënë këtë të fundit me vetëm 7 anëtarë. Një nga 7 gjyqtarët e mbetur është gjyqtarë në detyrë, duke pasur parasysh që mandati i saj kishte përfunduar që në vitin 2017. Nga gjithsej 9 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, tre prej tyre zgjedhen nga Presidenti, tre nga Kuvendi dhe tre të tjerë nga Gjykata e Lartë. Tre gjyqtarët e rinj (përfshirë atë që zëvendëson gjyqtarin në detyrë) do të zgjedhen nga Gjykata e Lartë. Kjo e fundit ka nisur aktualisht procedurën për aplikime, në përputhje me Ligjin. Nëse nuk zhvillohet ndonjë procedurë e përsheptuar për zgjedhjet në këtë gjykatë, duke marrë parasysh periudhën tremujore gjatë së cilës Gjykata Kushtetuese duhet të shpallë vendimin e saj përfundimtar, duket se kjo Gjykatë do të duhet të merret me këtë çështje me përbërjen aktuale jo të plotë.

## VENDIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE – CILAT JANË ALTERNATIVAT?

Gjykata Kushtetuese ka 3 (tre) muaj kohë për të nxjerrë një vendim lidhur me shkarkimin e Presidentit Ilir Meta. Gjykata vazhdon gjykimin e çështjes, edhe nëse Presidenti vendos të japë dorëheqjen para shpalljes së vendimit nga Gjykata.<sup>16</sup>

Sa i përket vendimmarrjes, Gjykata Kushtetuese mund:

- A** Të konfirmojë vendimin e Kuvendit për shkarkimin e Presidentit: në një rast të tillë, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se Presidenti i Republikës ka shkelur rëndë Kushtetutën dhe deklaron shkarkimin e tij nga detyra. Në këtë rast, vendimi i Gjykatës Kushtetuese hyn në fuqi në ditën e shpalljes dhe publikohet menjëherë në Fletoren Zyrtare.
- B** Të shfuqizojë vendimin e Kuvendit; në këtë rast, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se nuk ka shkelje të Kushtetutës dhe Ilir Meta mbetet President i Shqipërisë.
- C** Të mos marrë një vendim; kjo ndodh nëse Gjykata Kushtetuese nuk siguron shumicën e votave të anëtarëve të saj. Në këtë rast, e gjithë procedura bëhet e pavlefshme dhe Presidenti vazhdon të ushtrojë funksionin e tij.

Sfida kryesore për Gjykatën Kushtetuese është të vendosë nëse Presidenti e ka shkelur “rëndë” Kushtetutën. Duke qenë se as Kushtetuta dhe as ndonjë ligj tjetër nuk definojnë kuptimin e “shkeljes së rëndë” të Kushtetutës, ka shumë gjasë që Gjykata Kushtetuese t’i drejtohet Komisionit të Venecias për një opinion mbi këtë çështje.<sup>17</sup>


## ÇFARË NDODH PAS VENDIMIT? – SKENARËT E MUNDSHËM

Skenarët e mësipërm **B** dhe **C** prodhojnë rezultat të qartë. Nga ana tjetër, mbetet e panjohur se çfarë do të ndodhë nëse Gjykata vendos për shkarkimin e Presidentit (**A**). As Kushtetuta dhe as ndonjë ligj tjetër nuk rregullojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë procesin dhe afatin kohor për zgjedhjen e Presidentit të ri pas shkarkimit të Presidentit aktual. Për më tepër, nuk ka as precedentë të mëparshëm që do të mund të shërbenin si shembuj. Një tjetër pengesë për procesin do të jetë edhe përfundimi i mandatit të Kuvendit. Ndonëse mandati i përfundon zyrtarisht më 9 shtator 2021, Kuvendi mund të mblidhet vetëm deri më 8 korrik 2021, 60 ditë para përfundimit të mandatit të tij.<sup>18</sup> Prandaj, duket se procesi dhe afati për zgjedhjen e presidentit të ri do të varen në një masë edhe nga data e vendimit të Gjykatës.

<sup>16</sup> Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës Së Shqipërisë 63 (3)

<sup>17</sup> Ekonomia Online “Tre variantet e vendimit për Metën, Kushtetuesja mund t’i drejtohet edhe komisionit të Venecias”, 16 qershor 2021, <https://ekonomiaonline.com/globi/tre-variantet-e-vendimit-per-meten-kushtetuesja-mund-ti-drejtohet-edhe-komisionit-te-venecias/?fbclid=IwAR0hR2egfbtHYD-DX2Fc62LxxSpXF8pVM3FwlKfcdAvRVqK2IXDGIWVg6l>

<sup>18</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 65 (4)



Nëse Gjykata Kushtetuese e merr vendimin para konstituimit të Kuvendit të ri, Kuvendi në ikje nuk mund ta zgjedhë dot Presidentin e ri.<sup>19</sup> Prandaj, një zgjidhje do të ishte që Kryetari i Kuvendit të shërbente formalisht si President në detyrë për jo më shumë se 60 ditë. Në këtë drejtim, ka ngjashmëri të kësaj procedure me atë të Kosovës, ku po ashtu parashihet që Kryetari i Kuvendit të shërbejë përkohësisht si President i Republikës. Nëse gjatë kësaj kohe konstituohet Kuvendi i ri i Shqipërisë, Kryetari i ri i Kuvendit merr automatikisht postin e Presidentit deri në zgjedhjen e Presidentit të ri.<sup>20</sup> Për zgjedhjen e Presidentit të ri në tre raundet e para duhen 84 vota. Kështu, Partia Socialiste mund të përdorë periudhën 60-ditore për të arritur konsensusin me partitë e tjera politike. Nëse Presidenti nuk zgjedhet në tre raundet e para, për raundin e katërt dhe të pestë nevojiten vetëm 71 vota. Në këtë rast, Partia Socialiste nuk do të ketë nevojë për konsensus, pasi që do t'i ketë votat e mjaftueshme me 74 vendet e fituara në Kuvend.

Sidoqoftë, duket mjaft e mundshme që Gjykata të mos nxjerrë një vendim deri pas krijimit të Kuvendit të ri; veçanërisht nëse kërkon një opinion nga Komisioni i Venecias. Në këtë rast, për shkak të mungesës së dispozitave kushtetuese dhe ligjore, është e paqartë se brenda çfarë afati kohor do të zgjedhet Presidenti nga Kuvendi i ri. Ky i fundit do të duhet të mbështetet në dispozita të tjera që nuk rregullojnë, në thelb, zgjedhjen e Presidentit të ri pas shkarkimit të Presidentit aktual nga detyra, por që do të mund të funksiononin për çështjen në fjalë.

**Zgjedhja e Presidentit**

Tre raundet e para - **84 VOTA**  
Raundi i katërt dhe i pestë - **84 VOTA**

**Nëse dështon zgjedhja e Presidentit në të pesë raundet**

- ▶ Shpërndahet Kuvendi
- ▶ Shpallen zgjedhje të reja brenda 45 ditësh
- ▶ Presidenti i ri zgjedhet me **71 Vota**

<sup>19</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 65 (4)

<sup>20</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 65 (4)

Kështu, Kuvendi duhet të zgjedhë mes procedurave të ndryshme për zgjedhjen e Presidentit të ri:

- Të zbatojë Nenin 91 (1) që përcakton se “kur vendi i Presidentit mbetet vakant, Kryetari i Kuvendit zë vendin dhe ushtron kompetencat e tij”. Kjo do të thotë se Kuvendi do të zgjedhë Presidentin e ri brenda 60 ditëve. Kjo procedurë mund t’u sigurojë partive parlamentare më shumë kohë për të arritur konsensus për zgjedhjen e Presidentit.
- Megjithatë, Kuvendi mund të zgjedhë të zbatojë Nenin 91 (2) i cili parashikon se “Në rast se Presidenti nuk mund të ushtrojë detyrën për më shumë se 60 ditë, Kuvendi, me dy të tretat e të gjithë anëtarëve, vendos dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila vërteton përfundimisht faktin e pamundësisë. Në rast të vërtetimit të pamundësisë, vendi i Presidentit mbetet vakant dhe zgjedhja e Presidentit të ri fillon brenda 10 ditëve nga dita e vërtetimit të pamundësisë.” Ky nen i referohet vetëm “pamundësisë së Presidentit për të ushtruar detyrën” dhe nuk ka lidhje me rastin e shkarkimit të Presidentit. Megjithatë, si “pamundësia” ashtu edhe “shkarkimi” kërkojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese për t’i dhënë fund mandatit të Presidentit. Në të dy rastet, mandati i Presidentit përfundon para kohe. Kësisoj, Kuvendi mund të zbatojë të njëjtën procedurë për zgjedhjen e Presidentit të ri, pas vendimit të mundshëm të Gjykatës Kushtetuese për shkarkimin e Presidentit aktual.

## PËRFUNDIM

Gjykata Kushtetuese do ta ketë mjaft të vështirë përkufizimin e termit “shkelje e rëndë” e Kushtetutës. Asaj do t’i duhet të përcaktojë faktorët kryesorë përkatës që duhet të merren parasysh për të përcaktuar se cilat veprime mund të konsiderohen shkelje e “rëndë” e Kushtetutës. Prandaj, ka shumë gjasë që Gjykata të kërkojë një mendim të Komisionit të Venecias, gjë që do ta vonojë në mënyrë të pashmangshme procedurën dhe vendimin lidhur me shkarkimin e Presidentit.

Një tjetër betejë do të jetë procesi dhe afati kohor për zgjedhjen e Presidentit të ri, nëse Gjykata shkarkon Presidentin Ilir Meta. Edhe pse të gjithë skenarët e mësipërm mund të konsiderohen të mundshëm, kjo çështje mbetet subjekt i interpretimeve të mëtejme të institucioneve përkatëse gjyqësore, ligjore dhe politike në Shqipëri. Çfarëdo dhe kurdo që të ndodhë, konsensusi për zgjedhjen e Presidentit të ri do të jetë i nevojshëm. Pas viteve me tensione politike në Shqipëri, zgjedhja e një Presidenti që i bashkon të gjithë ka rëndësi të madhe dhe konsensusi mes deputetëve mund t’i shërbejë një qëllimi të tillë.

Pa dyshim, çështja në fjalë ka nxjerrë në pah mangësitë kushtetuese dhe ligjore që e vështirësojnë procesin edhe më shumë. Prandaj, vendimi i Gjykatës Kushtetuese në këtë rast do të shërbejë si bazë për përmirësimin e rregullave në procedurën e zgjedhjes së Presidentit dhe si precedent për rastet e ngjashme që mund të ndodhin në të ardhmen. Meqë ky është rasti i parë që ndodh në Shqipëri, vështirësitë dhe paqartësitë që ndërliken me të do të krijojnë nevojën për ndryshime të mundshme të Kushtetutës dhe/ose ligjeve përkatëse në të ardhmen, me qëllim që të plotësohen boshllëqet aktuale dhe të parandalohen krizat e ardhshme institucionale.



Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (BPRG) është një organizatë pavarur rajonale, me qendër në Prishtinë, Kosovë. Ne ofrojmë analiza dhe rekomandime të politikave zhvillimore për një sërë çështjesh të ndërlidhura me shtet-ndërtim; konsolidim institucional e demokratik; integrimin e minoriteteve, dhe marrëdhënieve ndërshtetërore; si dhe integrimin Evropian dhe reformave politike. Ne kemi përvojë në hartimin, raportimin dhe zhvillimin e politikave, qasje strategjike dhe avokim me qeverinë, institucione ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare.

Në thelbin e punës sonë qëndrojnë raportet tona rigorozë, të detajuar dhe të paanshme, të bazuara gjithmonë në hulumtimet në terren. Ne shkojmë përtej qëndrimeve kryesore dhe kërkojmë të bëjmë ndryshime përmes rekomandimeve për politika të cilat janë krijuese, të realizueshme dhe të matshme,

për të ndihmuar në zhvillimin e demokracive të forta dhe shoqërive të bazuara në sundimin e ligjit në Ballkanin Perëndimor.

Ne angazhohemi në avokim të nivelit të lartë, si në rajon ashtu edhe ndërkombëtarisht, duke ndikuar njëkohësisht në diskutime mbi politikën, punët e brendshme dhe politika evropiane për Ballkanin Perëndimor.

Për të arritur këtë, Grupi për Ballkan ka dizajnuar instrumente dhe platforma t

**Dialogu Politik** promovon dialogun e brendshëm të Kosovës, dhe agjendën e krijimit të reformave.

### **Forumi i Politikave (një Forum i Avokimit të Nivelit të Lartë-Mendimtar)**

përmirësuar dialogun midis shoqërisë civile dhe institucioneve.

### **Grupi për Avokim dhe Politika Kosovë-Serbi (një forum për bashkëpunimin ndërkufitar të shoqërisë civile)**

midis Kosovës dhe Serbisë, dhe shoqërive të tyre.

**Gratë në politikë** promovon fuqizimin e grave dhe vajzave; sigurinë dhe gjithë-përfshirjen e tyre; dhe angazhohet të forcoj ndikimin e Grupit të Grave në tërë Kosovën.

**Plaforma për Dialogun** promovon procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke informuar publikun më të gjerë dhe duke nxitur debat për marrëveshjet, përfitimet dhe sfidat e Dialogut

**Komponenti i Mbështetjes nga Ekspertët** siguron mbështetje për qeverinë dhe institucionet kryesore në fushat e politikave, paqes dhe agjendat e shtet-ndërtimit



Norwegian Embassy